

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

A l b G a r d e n

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K37513520N

NUIS/NIPT

Lagjja Skenderbeg , godine private 1 kateshe ne superstraden Lezhe - Shkoder, km 1

Adresa

Lezhë

Albania

4501

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0682020802

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

021523801

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

infoalbgarden@gmail.com

E-mail

Administrator Pjetër Trashaj

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/07/14

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355682020802

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

021523801

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-74343-07-05-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelberimit Tirane

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

59500000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje peme dekorative per Pyllin Orbital dhe zona te ndryshme te Tiranës

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/08/07

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/08/07

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/49175/07052023

03452000-3

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe me VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disë operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Në datë 06.07.2023 Autoriteti Kontraktor DPPGJ ka publikuar procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pemë dekorative për Pyllin Orbital dhe zona të ndryshme të Tiranës” me fond limit 59.500.000 (pesëdhjetë e nëntë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 07.08.2023 ora 11:00.

Pasi jemi njohur me dst, nga verifikimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit konstatojmë se disa prej tyre janë vendosur në kundërshtim të plotë me Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe me VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Më konkretisht parashatrojmë se:

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Në datë 06.07.2023 Autoriteti Kontraktor DPPGJ ka publikuar procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pemë dekorative për Pyllin Orbital dhe zona të ndryshme të Tiranës” me fond limit 59.500.000 (pesëdhjetë e nëntë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 07.08.2023 ora 11:00.

Pasi jemi njohur me dst, nga verifikimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit konstatojmë se disa prej tyre janë vendosur në kundërshtim të plotë me Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe me VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Më konkretisht parashatrojmë se:

1) Në shtojcën 5, FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, AK ka kërkuar: “Bimësia dekorative (drurë _shkurre) dhe kompozimi në gjelbërim.

Në sipërfaqet e gjelbëra elementi bazë dhe faktori kryesor që përcakton kompozimin e tyre estetik mbetet gjithmonë bimësia dekorative.

Bimësia dekorative mund të lihet me rritje natyrore ose mund ti jepet edhe forma të rregullta sferike dhe gjeometrike, paralelepipedë, konike, etj.

Veçoritë e drurëve dekorativë:

- ? drurë me kurorë ovale; Panja, Mështekëna, Ahu, Gështenja, Sofora, Bli, Lisi, etj.
- ? drurë me kurorë të rrumbullakët; Gështenja e Kalit Katabla, Plepi, Shelgu etj,
- ? drurët me kurorë konike; Likuidambër, Manjolë, Rrapi, Bli, Akacia etj.
- ? drurë me kurorë si kolonë; Mështekën, Ah, Verri, etj.
- ? drurë me kurorë sferike; Panja, Frashëri, Akacia etj.
- ? drurë me kurorë të shtrirë si çadër; Julibrisimi, Plepi i Bardhë, Cedruset, Pishat, etj.
- ? drurë me kurorë konike; Bredhi, Selvia, Varshi, Gjinko, Kryptomeria, Pisha, Sekuoja, Tisi(nuk egziston në preventiv) , Selvi e Kënetave, etj.
- ? drurë me kurorë vajtuëse; Shelgu vajtuës”.

Ndërkohë në Shtojcën 6 FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT, AK ka kërkuar të gjithë sasinë e artikujve që kërkon të prokurojë, në total një listë mbi 70 artikuj (bimë e

shkurre dekorative).

Nga verifikimi i listës së artikujve të përcaktuar nga AK në shtojcën 6 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit” në raport me specifikimet teknike të kërkuara nga AK në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” rezulton se në dst janë përcaktuar specifikime teknike për disa artikuj të cilët nuk figurojnë në formularin nr. 6 dhe për të cilat OE nuk do të paraqesin ofertë dhe konkretisht për artikujt:

Mështekëna; Gështenja e Kalit; Mështekën, Verri, Julibrisimi, Varshi, Gjinko, Kryptomeria, Sekuoja, Tisi, rezulton se pavarësisht se janë pasqyruar në shtojcën 5 Formulari i Specifikimeve Teknike të dst, këto artikuj nuk figurojnë tek lista me mbi 70 artikuj në shtojcën 6 Formulari i Sasisë dhe Grafikut të lëvrimit.

Në nenin 36 Specifikimet teknike të Ligjit nr. 162/2020 përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet”.

Ndërsa në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet se:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Referuar kërkesave të AK qartazi rezulton një mospërputhje ndërmjet artikujve për të cilat kërkohen specifikime teknike por nuk kërkohet ofertë.

Ky fakt na sjell konfuzion në ndërtimin e ofertës ekonomike.

Gjithashtu këto kërkesa të AK bien në kundërshtim të plotë me nenin 36 të LPP dhe nenin 40 të VKM 285 si mësipër cituar.

Si përfundim kërkojmë saktësimin e këtyre përcaktimeve nga ana e AK, duke qartësuar kërkesat e dst.

2) Në shtojcën 7, pika 2 KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, nën-pika 2.3 Kapaciteti teknik, AK ka kërkuar kriteret:

“2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor që të kenë stafin inxhinierik si më poshtë të cilin ta ketë të punësuar të paktën në 3 muajt e fundit dhe të kenë të paktën 5 vite eksperiencë pune, si dhe të përfshirë në licencën e shoqërisë si më poshtë:

- | | | |
|----|--------------------|---------|
| a. | Inxhinier Topograf | 1 (një) |
| b. | Inxhinier Agronom | 2 (dy) |
| c. | Inxhinier Mjedisi | 1 (një) |
| d. | Inxhinier Pyjesh | 1 (një) |

Në rastin e shpalljes fitues të Operatorit Ekonomik, para lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktor

do të kërkojë nga OE fitues të paraqes për fuqinë punëtore dokumentacionin (original ose kopje e noterizuar) të sipërcituar.

Gjithashtu për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- ? CV
- ? Kontratë pune të vlefshme
- ? Diplomë
- ? Liçencë (nëse është e zbatueshme / nëse Inxhinieri është i pajisur me liçencën përkatëse, referuar nenit 40/5/(b) të VKM 285, datë 19.05.2021)
- ? Librezë pune

Lidhur me këtë kërkesë të AK, konstatojmë se përcaktimi i kërkuar nga AK që stafi Inxhinierik duhet të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune është një kërkesë e pambështetur ligjërisht dhe totalisht diskriminuese.

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit 162/2020 pika 4 përcaktohet se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Në VKM nr. 285, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pikat 3, 4 dhe 5 përcaktojnë se:

3. “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

4. “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

5. “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Në parashikimet ligjore të sipërcituara (si në ligj ashtu edhe në VKM), rezulton se Ligjvënësi kërkon që OE konkures të disponojnë aftësi profesionale si dhe personel të nevojshëm për të garantuar realizimin me sukses të kontratës, e me qëllim përmbushjen e këtij kriteri, kërkohen të paraqiten Liçensat e stafit të kualifikuar. Gjithashtu, ligjvënësi ka përcaktuar edhe përvojën e mëparshme si një kriter i cili provon se një Operator ekonomik disponon eksperiencë dhe besueshmëri për realizimin e një kontrate. Ndërkohë që në asnjë nen apo paragraf të ligjit dhe VKM nuk parashikohet kërkesa për “vjetërsinë” e stafit teknik. Ky kriter provohet dhe përmbushet nga licenca e Inxhinierëve, dokument i cili tregon nivelin e kualifikimit të inxhinierve dhe i shërben AK për të krijuar idenë dhe bindjen se OE konkures i zotëron kualifikimet e nevojshme. Referuar sa mësipër, rezulton se kërkesa e AK që stafi Inxhinierik duhet të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune është një kërkesë abuzive, e cila nuk gjen asnjë mbështetje si në nenin 77 të Ligjit 162/2020 ashtu edhe në nenin 40 të VKM 285, e për rrjedhojë është një kërkesë diskriminuese ndaj OE të cilët duan të konkurojnë në këtë procedurë prokurimi.

Për pasojë ky kriter duhet të modifikohet, duke hequr kërkesën për 5 vite eksperiencë pune.

3) Në shtojcën 7, pika 2 KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, nënpika 2.3.4 Kapaciteti teknik, AK ka kërkuar kriteret:

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik të cilin ta ketë të punësuar në 3 muajt e fundit si më poshtë:

- | | | | |
|-------|---|---------|---|
| a. | Specialistë punimesh për lartësi | 3 (tre) | |
| b. | Manovratorë - automakinistë | 3 (tre) | |
| c. | Manovratorë – Eskavatoristë | | 1 |
| (një) | | | |
| d. | Ekspert për ndihmën e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave | 1 (një) | |
| e. | Specialist për përgjegjesinë dhe shendetin në punë | 1 (një) | |
| f. | Teknik mekanik | 1(një) | |

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

? kontratë punë të vlefshme

? diploma/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara/licencuara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore

? dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror

Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve

? Listëpagesat E-SIG 25 të 3 muajve të fundit, me vulë elektronike të vlefshme të verifikueshme në sistem.

*OE mund të sigurojë shërbimin nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore për automakinistët me kontratë të vlefshme pune që mbulon të gjithë periudhën e ekzekutimit të shërbimit në kontratë.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për kete objekt kontrate shërbimi duhet të disponojë fuqi punëtore duke përfshirë këtu, të stafit inxhinierik dhe tekniko-profesional prej minimalisht 49 persona si dhe të figurojnë në listpagesat e punonjësve për 3 muajt e fundit me:

? Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;

? Listë - pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe

shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqisë punëtore, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Referuar kriterit të numrit prej 49 punonjës (përfshirë stafin prej 5 Inxhinierësh) rezulton se për realizimin e kësaj kontrate kërkohet një numër total prej 44 punëtorë. Ky kriter kualifikimi është tërësisht abuziv dhe në kundërshtim të plotë me Ligjin dhe Rregullat e Prokurimit Publik. Më konkretisht bëjmë me dije se:

Shoqëria jonë ka një eksperiencë prej 30 vjetësh në fushën e gjelbërimit të mjediseve urbane. Gjithashtu kemi njohuri të thelluara dhe profesionale për të gjitha proceset që kërkojnë mbjellja, dhe mirëmbajtja e bimësisë dekorative të të gjitha llojeve. Po kështu, ne jemi një nga kontraktorët kryesorë të Autoritetit tuaj kontraktor, dhe kemi realizuar mjaftueshëm kontrata me këto objekte. Referuar eksperiencës tonë, referuar kërkesave teknike, sasisë dhe grafikut të lëvrimit të mallit objekt kontrate që kërkohet të prokurohet nga ana juaj, si dhe referuar metodologjisë dhe mjeteve e makinerive që do të përdoren për proceset e mbjelljes së drurëve e shkurreve dekorative, shoqëria jonë ka kryer një analizë të hollësishme të fuqisë punëtore që është e nevojshme për realizimin e kësaj procedure.

Analiza 1 për mbjelljen e drurëve dekorativë.

i) Referuar sasisë dhe grafikut të lëvrimit në dst, rezulton se numri total i drurëve që kërkohet të mbillen është 1218 drurë (shiko Tabelën nr.1), dhe muaji Nëntor 2023 është muaji kur do të mbillet sasia më e madhe e drurëve dekorativë gjithsej 538 copë ose mesatarisht e llogaritur për 22 ditë pune do të mbillen 24 drurë/ditë;

ii) Në dst janë të përcaktuar edhe mjetet për mbjelljen e drurëve ku është kërkuar mini – eskavator. Një mjet mini – eskavator mund të hapë minimalisht 10 gropa me përmasa 80x80x80cm në 1 orë. Ky fakt do të thotë se nevojitet 1 eskavatorist, i cili për max 2.4 orë hap 24 gropa, ndërsa për 8 orë mund të hapë 80 gropa;

iii) Gjithashtu, për procesin e mbjelljes së drurëve nevojiten dhe mjetet dumper, dhe/ose kamionçinë 3.5 ton, të cilët kryejnë procesin e hedhjes së dheut vegjetal në gropa (pra 1 manovrator/autokamionist);

iv) Në vijim, nevojitet edhe një kamion me vinç për vendosjen në gropat e hapura të drurëve dekorativë me perimetër të madh, pasi ato kanë edhe peshë të madhe (pra 1 manovrator/autokamionist).

v) Për realizimin e procesit të mbjelljes, sipas përcaktimeve të AK në shtojcën 5 nevojiten 3 punëtorë (pra 3 punëtorë).

vi) Gjithashtu, këtu mund të shtojmë edhe max 3 punonjës për transportin (shofer kamionçinë, dy punonjës transporti).

Referuar analizës së sipërcituar, duke përfshirë edhe punonjësit e tjerë të kërkuar si: ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave; specialist për përgjegjësinë dhe shëndetin në punë; dhe teknik mekanik, rezulton se për të realizuar procesin e mbjelljes së drurëve nevojiten gjithsej 12 punonjës. Ndërkohë numri prej 44 punonjësish i kërkuar nga AK është tejet i ekzagjeruar, dhe jo në përputhje me natyrën e përmasat e kontratës, pra është një kriter diskriminues.

Analiza 2 për mbjelljen e shkurreve dekorativë.

i) Referuar sasisë dhe grafikut të lëvrimit në dst, rezulton se numri total i shkurreve që kërkohet të mbillen është 15.000 shkurre (shiko Tabelën nr.1), dhe muaji Shtator 2023 është muaji kur do të mbillet sasia më e madhe e shkurreve dekorative Norium Oleander, gjithsej 10.000 copë ose mesatarisht e llogaritur për 454 shkurre/ditë pune (gjithsej 22 ditë pune/1 muaj);

ii) Në dst janë të përcaktuar edhe mjetet për mbjelljen e drurëve ku është kërkuar mini –

eskavator. Një mjet mini – eskavator mund të hapë 50 gropa në vijë lineare/1 orë. Ky fakt do të thotë se nevojitet 1 eskavatorist, i cili mund të hapi 454 gropa/ditë për 8.5 orë;

iii) Gjithashtu, për procesin e mbjelljes së drurëve nevojiten dhe mjetet dumper, dhe/ose kamionçinë 3.5 ton, të cilët kryejnë procesin e hedhjes së dheut vegjetal në gropa (pra 1 manovrator/autokamionist);

iv) Në vijim, nevojitet edhe një kamion për transportin e shkurreve në gropat e hapura (pra 1 manovrator/autokamionist).

v) Për realizimin e procesit të mbjelljes, sipas përcaktimeve të AK në shtojcën 5 nevojiten 3 punëtorë (pra 3 punëtorë).

vi) Gjithashtu, këtu mund të shtojmë edhe max 2 punonjës për transportin (shofer kamionçinë, dy punonjës transporti).

Referuar analizës së sipërcituar, duke përfshirë edhe punonjësit e tjerë të kërkuar si: ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave; specialist për përgjegjësinë dhe shëndetin në punë; dhe teknik mekanik, rezulton se për të realizuar procesin e mbjelljes së shkurreve nevojiten gjithsej 12 punonjës. Ndërkohë numri prej 44 punonjësish i kërkuar nga AK është tejet i ekzagjeruar, dhe jo në përputhje me natyrën e përmasat e kontratës, pra është një kriter diskriminues.

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit 162/2020 pika 1 përcaktohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

Në VKM nr. 285, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 5 përcakton se:

5. “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtoare të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Referuar parashikimeve ligjore të sipërcituara, rezulton se AK duhet të kërkojë nga OE konkures në një procedurë prokurimi kriterin për fuqi punëtoare të nevojshme për ekzekutimin e objektin të kontratës. Vlen të theksojmë faktin se kjo kontratë është furnizim malli e për rrjedhojë kërkesa për 44 punëtorë siç e analizuam edhe mësipër është një kërkesë e paarsyetuar, e egzagjeruar, e cila synon të kufizojë konkurrencën duke thyer qëllimin dhe parimet e Ligjit të Prokurimit Publik. Në kërkesat e DST rezulton se kjo kontratë do të ekzekutohet për 4 muaj, dhe ky fakt përsëri e bën të egzagjeruar kërkesën për këtë numër kaq të lartë punonjësish. Nga verifikimi i dst, konstatojmë se mungon një argumentim i qartë dhe justifikues i numrit kaq të lartë të punonjësve të kërkuar në raport me proceset konkrete dhe afatin që nevojitet për realizimin me sukses të kontratës.

Me përcakimin e kriterit për vërtetimin e disponimit të minimalisht 44 punonjës + 5 inxh në total 49 punonjës, rezulton se Autoriteti kontraktor ka tejkalar natyrën dhe përmasat e kontratës pasi një numër i tillë punonjësish është tërësisht jo proporcional me objektin e prokurimit. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme të provohet disponimi i punonjësve, por kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme duke pasur parasysh elementë të tillë si natyra e kontratës, volumi i saj si dhe kohëzgjatja.

Në këtë kuptim vlerësojmë se AK duhet të modifikojë kriterin për fuqinë punëtore duke përcaktuar një numër të arsyeshëm dhe proporcional me volumin e furnizimeve të nevojshme, si dhe numrin e drurëve që do të mbillen, sipas afatit të caktuar, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të Ligjit për Prokurimin Publik.

Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës duke evituar kushte kufizuese sikundër në rastin konkret, pasi një kriter i tillë nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës por krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë.

Për pasojë ky kriter duhet të modifikohet, duke ulur kërkesën për numrin e kërkuar të punonjësve.

4.) Gjithashtu, Në shtojcën 7, pika 2 KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, nënpika 2.3 Kapaciteti teknik, AK ka kërkuar kriterin:

Specialistë punimesh për lartësi.

Referuar proceseve teknike të kërkuara në dst, rezulton se në asnjë rresht apo paragraf të dst nuk kërkohet ndonjë proces pune kërkesë e veçantë që lidhet me punime në lartësi e rrjedhimisht edhe kjo kërkesë e AK nuk është në përputhje me natyrën e kontratës dhe bie në kundërshtim të plotë me nenin 77 të LPP dhe nenin 40 të VKM nr. 285.

Referuar këtij arsytimi kërkohet heqjen e këtij kriteri.

5) Në shtojcën 7, pika 2 KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, nënpika 2.3.10 Kapaciteti teknik, AK ka kërkuar:

“2.3.10. Ofertuesi të paraqesë, përpara afatit të fundit për hapjen e ofertave, nga një mostër për artikujt e mëposhtëm:

1. Pishë e butë (Pinus Pinea), me perimetër 45_50 cm në 1.3 m nga toka) / artikulli Nr. 7 në preventiv.
2. Rrap, (platanus orientalis), (me perimetër 80_85 cm në 1.3m nga toka) / artikulli Nr.11 në preventiv.
3. Rrap, (platanus orientalis), (me perimetër 60_70 cm në 1.3m nga toka) / artikulli Nr. 12 në preventiv.
4. Panjë e kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3m nga toka) / artikulli Nr. 22 në përeventiv.
5. Tespie (me perimetër 45_50 cm në 1.3m nga toka) / artikulli Nr.28 në preventiv.
6. Cedër (Cedrus Deodora), (me perimetër 55_60 cm në 1.3 m nga toka) / artikulli Nr. 36 në përeventiv.

Mostrat të paraqiten dhe të dorëzohen në magazinën e DPPGJ (përkatësisht në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit, Rruga 5 Maji, Tiranë), së bashku me listën e mostrave të protokolluar në DPPGJ përpara afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. Një kopje e listës së mostrave të protokollohet dhe të dorëzohet në zyrën e protokoll-arkives ne DPPGJ”.

Gjithashtu, në shtojcën 5 “Specifikimet Teknike” dhe 6 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit” rezulton se AK ka përcaktuar në mënyrë të detajuar kërkesat dhe specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi, si dhe sasinë e mallit, dhe grafikun e ekzekutimit të kontratës.

Referuar kriterit të kërkuar nga AK për paraqitjen e mostrave, si dhe përcaktimeve në DST të specifikimeve teknike, ju bëjmë me dije se kriteri për paraqitjen e mostrave (bimëve dekorative) përpara hapjes së ofertave, është tërësisht abuziv dhe në kundërshtim të hapur me Ligjin 162/2020 dhe VKM 285. Më konkretisht parashtrojmë:

Në VKM nr. 285, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6 përcakton se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t’argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
- c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

Së pari referuar kriterit të kërkuar nga AK rezulton se ai nuk është vendosur në përputhje me përcaktimin e mësipërm ligjor, pasi ligjvënësi në nenin 40 pika 6 të VKM 285, ka përcaktuar në mënyrë të qartë se kërkesa e sipërcituara janë alternative dhe jo kumulative, pra AK mund të kërkojë mostrat; dhe/ose fotografitë apo katalogët teknikë të mallit objekt kontrate; dhe/ose dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, ndërkohë që në rastin konkret AK në mënyrë abuzive ka kërkuar edhe mostrat edhe specifikimet teknike, dhe kërkesa të tjera teknike që lidhen me mallin objekt kontrate.

Së dyti kriteri për paraqitjen e mostrave është në kundërshtim me parashikimet ligjore nenit 77 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenit 40 VKM 285 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” pasi kjo kërkesë bie në kundërshtim me objektin dhe natyrën e kësaj kontrate. Sjellim në vëmendjen tuaj se objekt i kësaj kontrate është furnizim drurë dhe shkurreve dekorative dhe AK është një autoritet me përvojë në prokurimin e drurëve dhe shkurreve dekorative e në këtë kuadër paraqitja e katalogëve, fotografive apo skedave teknike të bimëve dekorative e përmbush më së miri qëllimin e AK, duke krijuar një panoramë të qartë për mallin që disponon secili konkurent.

Së treti, kërkesa e AK për paraqitjen e mostrave për disa artikuj që prokurohen bie në kundërshtim të hapur me kërkesat e nenit 77 të Ligjit 162/2020 si dhe shkel në mënyrë flagrante qëllimet dhe parimet e përcaktuara në nenet 2 dhe 3 të LPP. Më konkretisht sqarojmë se shumë prej bimëve dekorative objekt kontrate rriten/prodhohen jashtë Shqipërisë. Procedura e Prokurimi është publikuar në datë 06.07.2023 dhe është parashikuar për tu zhvilluar në datë 07.08.2023. Është e pamundur të sigurohen dhe paraqiten mostrat e kërkuara nga AK për një afat prej 30 ditësh. Po të marrim në konsideratë identifikimin ekzaktësisht se ku ndodhen bimët dekorative, përgatitjen për eksport të drurëve dhe shkurreve dekorative (mostrave), transportin dhe zhdoganimin e tyre, rezulton se është e pamundur të dorëzohen brenda afatit të kërkuar mostrat pranë AK. Ky fakt vlen si për OE shqiptarë që bashkëpunojnë me OE të huaj ashtu edhe për OE të huaj që duan të

konkurojnë në këtë procedure prokurimi. Gjithashtu, vlera e mallit që AK kërkon të paraqitet si mostër është rreth 12 mijë euro. Kjo përbën një kosto të konsiderueshme në ngarkim të OE që do të konkurojnë për këtë procedurë prokurimi dhe e cila nuk konsiderohet aspak nga AK. Kjo kërkesë e veçantë kualifikimi haptazi diskriminon OE shqiptarë që bashkëpunojnë me OE të huaj ashtu edhe për OE të huaj që duan të konkurojnë në këtë procedure prokurimi, pasi e kanë të pamundur në kohë reale të paraqesin mostra.

Së katërti, sjellim në vëmendjen tuaj se një dru dekorativ që importohet në Shqipëri në mënyrë që të qarkullojë lirisht qoftë edhe të përdoret si mostër, referuar kërkesave të VKM nr. 523 datë 13.07.2016 “Për Përcaktimin e Kritereve të Tregtimit e Çertifikimit të Materialeve të Shumëzimit dhe të Fidanëve të Bimëve Zbukuruese” në Kreun II, pika 1, gërma “d” përcaktohet se “1.

Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse: d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi.” Referuar afati kohor dhe procedurave që kërkohet që bimësia e kërkuar për mostër të pajiset me certificate përkatëse, rezulton se është e pamundur të arrihet ky afat.

Referuar arsyetimit të sipërcituar, kërkojmë që kriteri për paraqitjen e mostrave të hiqet.

6) Në shtojcën 7, pika 2 KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, nën-pika 2.3.8 Kapaciteti teknik, AK ka kërkuar kriteret:

”2.3.8 Ofertuesi duhet të disponojë të vetat ose me qira këto makineri:

Përshkrimi	Sasia
Kamion me vinç copë	3 (tre)
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës të paktën min 10 ton	3 (tre) copë
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 1 – 3.5 ton	1 (nje) copë
Eskavator me goma	1 (nje) copë
Fadromë copë	1 (nje)
Minieskavator	1 (nje) copë
Minifadromë	1 (nje) copë
Damper kantieri copë	2 (dy)
Autobot Uji copë	2 (dy)
Kokore/Kapele mbrojtëse nëntë) copë	49 (dyzetë e
Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila	5 (pesë) copë
Prozhektorë ndriçimi	5 (pesë) copë
Komplet i ndihmës së shpejtë	10 (dhjetë) copë
Tabelaparalajmëruese për bllokimin dhe devijimin e rrugës	20 (njëzetë) copë

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës 8 të DST duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtëm:

- a) Makineritë dhe pajisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje të lidhura para noterit publik, si dhe të shoqërohen me aktin e pronësisë të qiradhënësit (origjinal ose fotokopje e noterizuar).
- b) Kohëzgjatja e kontratave të qirasë për makineritë/pajisjet në fjalë duhet të mbulojë të

gjithë kohën e parashikuar në Grafikon e realizimit të kontratës.

c) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik me qira ose në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (Certifikatat pronësie, leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti). Për pajisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, origjinalë ose fotokopje e noterizuar. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara të jenë të shoqëruara me foto. Në rast se dokumentet e mësipërme janë në gjuhë të huaj, ato detyrimisht duhet të shoqërohen me një përkthim në gjuhën e ofertes, si dhe noterizimin e nënshkrimit të përkthimit”.

Referuar kriterit për paraqitjen e mjeteve dhe makinerive të sipërcituara rezulton se kriteri i sipërkërkuar bie në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit 162/2020 dhe nenin 40 të VKM nr. 285. Më konkretisht parashtrijmë se:

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit 162/2020 pikat 1 dhe 4 përcaktojnë se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Referuar parashikimeve ligjore të sipërcituara, rezulton se natyra dhe numri i mjeteve të kërkuara nga AK, për më tepër për një kontratë furnizim malli nuk është në përputhje dhe proporcionale me natyrën dhe objektin e kontratës. AK nuk ka dhënë asnjë argumentin ligjor apo teknik lidhur me kërkesat konkrete për mjetet e kërkuara, duke përcaktuar kështu kërkesa abuzive. Po kështu, nga analizave e proceseve të mbjelljes së drurëve dhe shkurreve dekorativë, ne evidentuam edhe mjetet konkrete që nevojiten për realizimin me sukses të kontratës. Nga kjo analizë rezulton se është e paqartë dhe e pambështetur teknikisht se pse kërkohet:

- 1) Prozhektorë ndriçimi (të gjitha punimet do të kryhen brenda 8 orarit të punës dhe nuk parashikohet asnjë proces që do të kryhet natën ku mund të nevojiten prozhektorë);
- 2) Kamion me vinç janë kërkuar 3, ndërkohë që referuar analizës tonë proceset e punës mund t'i kryejë edhe vetëm një kamion me vinç;
- 3) Dumper kërkohen 2, ndërkohë që referuar analizës tonë proceset e punës mund t'i kryejë edhe vetëm një dumper;
- 4) Mjetet: Eskavator me goma, fadromë dhe minifadromë, nuk nevojiten fare në procesin e mbjelljes së drurëve dhe shkurreve dekorativë, ndërkohë që në mënyrë të paargumentuar teknikisht janë kërkuar nga AK.

Referuar gjithë analizës së sipërcituar, rezulton se kriteri për mjete e makineri nuk është në përputhje me përmasat e kontratës e për pasojë ky kriter duhet të modifikohet.

Gjithashtu, pasi jemi njohur me kërkesat tuaja teknike, ju informojmë se ne kemi verifikuar pozicionin e koordinatave gjeografike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor DPPGJ sipas grafikut FV Pemë, lidhur me çdo rrugë ku kërkohet të mbillen drurët dhe shkurret dekorative. Nga verifikimi konkret që kemi kryer në terren bashkë me inxhinierin Gjeodet, në disa prej koordinatave gjeografike që ju keni përcaktuar në dst, rezulton se ka drurë të mbjellë (të cilët janë identikë në përmasa dhe lloj sipas kërkesave teknike të dst). Ky fakt krijon konfuzion për ne si shoqëri, pasi kordiniarar gjografike ne “grafikin e punimeve F.V “ AK ka percaktuar fillimin e rruges dhe mbarimin e rruges, nuk kemi koordinatat per secilin dru dekorativ pasi ka mbivendosje dhe konfuzion.

Bashkëlidhur do të gjeni sipas planin e rivelimit topografik i punuar nga inxh.gjeodet ,fotot dhe perimetetrin e drurve dekorativ . Ku dallohen qarte mbivendosjet e drurve indentik ne lloje dhe perma sipas kerkeses AK sipas specifikimeve teknike ne dst.

Në këto kushte kërkojmë saktësimin e koordinatave duke përcaktuar egzakhtësisht pozicionin per secilin (1/cope) dru dekorativ.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

Kërkojmë saktësimin e koordinatave gjeografike nga nje inxhinier gjeodet duke përcaktuar egzakhtësisht pozicionin per secilin (1/cope) dru dekorativ, pasi aktualishte jane kordinatat gjeografike fillim rruge dhe mbarim rruge , dhe ka konfuzion per ne si shoqeri pasi ka mbivendosje druresh dekorativ indentik sipas llojeve kerkuara ne specifikimet teknike ne dst.

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

7. Lista e informacionit konfidencial:

JO

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit: 021523801

E-mail: infoalbgarden@gmail.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar Pjetër Trashaj